



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të mandatit të dhënë Kuvendeve të Komunave të Republikës së Kosovës me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, i cili ligj është bazë për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të aplikimit të dispozitave të këtij ligji dhe duke pasur për bazë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarëve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjakovës me dt. 26.12.2008, miraton:

STATUTIN E KOMUNËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statuti i Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme do të njihet si “Statuti”) është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12 pika 3 Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 2

2.1 Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj rregullojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (në tekstin e mëtejme “Ligji”).

2.2 Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme do të njihet si “Komuna”) e ka statusin e personit juridik, të drejtën e posedimit dhe administrimit të pronës, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.

2.3 Selia e Komunës është në Gjakovë , rr. “Nëna Terezë” nr. 469.

2.4 Komuna mund të ketë flamurin e vet, dukja e të cilit do të përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës.

2.5 Komuna e ka festën e vet - 14 Qershorin, Ditën e Çlirimit të Gjakovës.

2.6 Komuna e ka emblemën e vet.

2.7 Asnjë subjekt ose person tjetër, përveç Komunës, nuk mund të përdorë emblemën dhe shenjat komunale apo simbolet, pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

2.8 Simbolet e Komunës mund të miratohen apo ndryshohen me dy të tretën (2/3) e votimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

Neni 3

Statuti zbatohet vetëm brenda kufijve të Komunës.

Neni 4

4.1 Komuna ka vulën e vet të rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit. Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës, i cili nxirret në pajtim me aktet ligjore në fuqi, të cilat rregullojnë këtë lëmi.

4.2 Vula e rrumbullakët përmban tekstin:

- rrethi i parë: Republika e Kosovës,
- rrethi i dytë: Komuna e Gjakovës,
- në mesin e vulës është emblema.

4.3 Vula e Protokollit të Komunës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë me tekstin:

- Republika e Kosovës,
- Komuna e Gjakovës,

___ Nr. _____, dt. _____

4.4 Vulat e Komunës të përshkruara në pikat 4.2 dhe 4.3 duhet ta kenë tekstin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

4.5 Me rregullore të veçantë do të përcaktohen organet e Kuvendit të Komunës të cilat kanë të drejtë ta kenë vulën.

Neni 5

Të gjitha organet dhe instancat e Komunës kujdesen që banorët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale; pa dallim prone apo ndonjë statusi tjetër, me qëllim që ata të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet komunale të të gjitha niveleve. Komuna me politikën dhe praktikën e saj do të ndihmoj në mbështetjen e bashkëjetesës në mes banorëve dhe të krijimit të kushteve adekuate për t'u mundësuar të gjitha komuniteteve që ta shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor. Termi "komunitet" nënkupton bashkësitë e banorëve që i përkasin grupit të njëjtë etnik, fetar ose gjuhësor.

Neni 6

6.1 Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit mund të ndërmerret nga:

- a) Kryetari i komunës;
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
- c) Me iniciativën e 15 % të qytetarëve me të drejtë vote në Komunë.

6.2 Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit duhet të dërgohet në Kuvendin e Komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës, para shqyrtimit final, duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim.

6.3 Çdo propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës siç përcaktohet në nenin 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

6.4 Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, shqyrtimeve dhe sipas vërejtjeve të parashtruara, Kuvendi vendos për miratimin e tekstit përfundimtar të Statutit.

Neni 7

Përdorimi i gjuhës zyrtare në Komunë do të aplikohet në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Vendbanimet

Neni 8

Territori i Komunës është përcaktuar në Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave. Komuna është e përbërë prej këtyre vendbanimeve:

- | | |
|----------------|------------------------|
| 1. Babaj Bokës | 47. Nec |
| 2. Bardhaniq | 48. Netic |
| 3. Batushë | 49. Nivokaz |
| 4. Bec | 50. Novosellë e Epërme |
| 5. Berjahë | 51. Novosellë e Ulët |
| 6. Bardhasan | 52. Orize |
| 7. Bishtazhin | 53. Osek Hylë |
| 8. Bitesh | 54. Osek Pashë |
| 9. Brekoc | 55. Pacaj |
| 10. Brovinë | 56. Palabardhë |
| 11. Cërmjan | 57. Pjetërshan |
| 12. Dallashaj | 58. Plançor |
| 13. Damjan | 59. Ponošec |
| 14. Devë | 60. Popoc |
| 15. Doblibarë | 61. Piskotë |

16. Dobrixhë	62. Qerim
17. Dobrosh	63. Qerret
18. Dol	64. Raçë
19. Dujakë	65. Radoniq
20. Duzhnjë	66. Rakoc
21. Firajë	67. Rakovinë
22. Firzë	68. Molliq
23. Fshaj	69. Morinë
24. Gërqinë	70. Ramoc
25. Gërgoc	71. Rashkoc
26. Goden	72. Rogovë
27. Guskë	73. Rracaj
28. Gjakovë	74. Rezinë
29. Hereq	75. Rrypaj
30. Jabllanicë	76. Sheremet
31. Jahoc	77. Shishman
32. Janosh	78. Skivjan
33. Kodrali	79. Smaq
34. Korenicë	80. Smolicë
35. Koshare	81. Sopot
36. Kralan	82. Stubëll
37. Kusar	83. Trakaniq
38. Kushavec	84. Ujz
39. Lipovec	85. Vogovë
40. Llugagji	86. Vraniq
41. Luginar	87. Zidi i Sadikagës
42. Madanaj	88. Zhabel
43. Marmull	89. Zhdredhë
44. Mejë	90. Zhub
45. Meqë	91. Zylfaj
46. Moglicë	

Neni 9.

9.1 Komuna ka të drejtë të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të saj për t'u ofruar më afër shërbime qytetarëve, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

9.2 Kuvendi i Komunës përcakton aktivitetet që mund t'i ushtrojnë vendbanimet, e që janë në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave të komunës.

9.3 Kuvendi i Komunës për këto njësi siguron ndarjen e resurseve nga komuna, që janë në përpjesëtim me përgjegjësitë dhe aktivitetet e përcaktuara.

Neni 10.

10.1 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësive të përcaktuara me ligj, Komuna mund të krijoj zyra komunale informuese apo shërbyese për të ofruar shërbime më pran qytetarëve të saj.

10.2 Zyrat komunale që do të funksionojnë në kuadër të Komunës, do të specifikohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.

Neni 11.

Zyra komunale duhet të përbëhet nga pjesa administrative dhe duhet të drejtohet nga personeli i cili emërohet nga Komuna. Për ushtrimin e detyrave të saj zyra duhet t'i marr fondet e nevojshme nga Komuna.

KOMUNA

Neni 12.

12.1 Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

12.2 Të gjitha autoritetet komunale u përgjigjen qytetarëve të Komunës në format e përcaktuara me ligj.

12.3 Qytetarët e komunës kanë të drejtë që të marrin pjesë në aktivitetet e Komunës, siç përshkruhet me ligj.

12.4 Komuna ka të drejtë të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të saj për t'u ofruar më afër shërbime qytetarëve, në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe të këtij statuti.

Kompetencat komunale

Neni 13

Komuna i ushtron kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin

Neni 14

Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- e) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;

- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal, skemave të nxehjes lokale dhe shërbimin e zjarrfikësve;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e përkujdesjes publike primare shëndetësore ,
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesjen e fëmijëve, përkujdesjen për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave, përkujdesjen, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe taksitë;
- o) emërtimin e rrugicave, të rrugëve dhe të vendeve të tjera publike;
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike
- q) turizmit
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira;
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër .

Kompetencat e deleguara

Neni 15

15.1 Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës i delegojnë përgjegjësi Komunës, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- a) shënimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale
- f) mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e Komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjtë në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.
- g) administrimin e plotë të pronës komunale, konform nenit 17 të Ligjit.

15.2 Institucionet e Republikës së Kosovës mund t'i delegojnë Komunës përgjegjësi shtesë, që janë në kuadër të kompetencave të tyre, me kusht që Komunës t'i sigurohen burime financiare.

ORGANET E KOMUNËS

Neni 16

16.1 Kuvendi i Komunës (në tekstin e mëtutjeshëm “Kuvendi”) është organi më i lartë në Komunë;

16.2 Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtutjeshëm “Kryetari”) është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi i Komunës

Neni 17

17.1 Kuvendi është organi më i lartë përfaqësues në Komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

17.2 Të gjithë qytetarët e Komunës mund të kandidohen për Kuvend, me kusht që ata t’i plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

17.3 Mandati i çdo anëtari të Kuvendit verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar.

17.4 Të gjithë anëtarët e Kuvendit duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

17.5 Anëtarët e Kuvendit, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtar.

17.6 Kuvendi i Komunës së Gjakovës përbëhet prej 41 anëtarëve.

Funksionet e Kuvendit të Komunës

Neni 18

18.1 Kuvendi funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit, akteve tjera nënligjore dhe rregulloreve komunale;

18.2 Kuvendi nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështjeve tjera financiare të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit dhe Rregullores së Punës;
- d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;

- e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas ligjit;
- f) zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit;
- g) niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- h) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) emërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- j) arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe brenda komunale;
- k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe
- l) përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

18.3 Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegoj pushtetin e tij Komitetit të Kuvendit, apo Kryetarit. Kuvendi mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Neni 19

19.1 Kryesuesin e Kuvendit e zgjedh Kuvendi nga radhët e anëtarëve.

19.2 Kryesuesi i Kuvendit zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

19.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit është me vota të fshehta.

19.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

19.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet Kryesues i Kuvendit.

Neni 20

Postin e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo-shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin e Komunës.

Mbledhja inauguruese

Neni 21

21.1 Kuvendi e mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

21.2 Mbledhja inauguruese e Kuvendit thirret nga Kryetari brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

21.3 Nëse Kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit mund të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur Kryetari është dashur të thirr mbledhjen inauguruese të Kuvendit.

21.4 Nëse anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit.

21.5 Mbledhjet e Kuvendit që mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit kryesohet nga anëtari më i moshuar i Kuvendit që është i pranishëm në mbledhje.

Mbledhjet e Kuvendit

Neni 22

22.1 Kryesuesi i Kuvendit thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit.

22.2 Kuvendi mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

22.3 Mbledhjet e Kuvendit gjithashtu mund të thirren me kërkesën e çerekut të numrit të të gjithë anëtarëve të Kuvendit ose nga Komiteti për Politikë e Financa.

22.4 Së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të Kuvendit ose tri ditë pune më herët në raste urgjente, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, si dhe për rendin e ditës së asaj mbledhjeje. Njoftimet publike për këto çështje shpallen në të njëjtën kohë.

Takimet e jashtëzakonshme të Kuvendit

Neni 23

23.1 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, apo me kërkesë të Kryetarit.

23.2 E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshinë të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.

23.3 Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

23.4 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me Rregulloret e punës, së paku tri ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

23.5 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Takimet e hapura

Neni 24

24.1 Takimet e Kuvendit dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohet pjesëmarrja në takime të Kuvendit, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës.

24.2 Njoftimi për takimin e Kuvendit bëhet publik.

24.3 Kuvendi apo Komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

- a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrregullim publik apo dhunë;
- b) takimi i hapur kërcënon të zbuloj informacione dhe dokumente të cilat janë të klasifikuara si të besueshëm sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare;
- c) kërcënon të zbuloj informacione të ndjeshme personale apo komerciale ose
- d) informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

24.4 Në rastet e tilla, Kuvendi njofton për vendimin e marrë.

24.5 Kuvendi mund të miratoj rregulla dhe procedura për mbajtjen e seancave të mbyllura.

Kuorumi

Neni 25

25.1 Kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve.

25.2 Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

Rendi i ditës

Neni 26

26.1 Rendi i ditës për takimin e Kuvendit caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

26.2 Anëtari i Kuvendit mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

26.3 Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.

26.4 Rregullorja e punës së Kuvendit parasheh dispozita tjera për përgatitjen, miratimin dhe ndryshimin e rendit të ditës.

Votimi

Neni 27

27.1 Në të gjitha takimet e Kuvendit dhe Komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe Kryesuesin, ka nga një votë, por Kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

27.2 Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në ligj, vendimet e Kuvendit aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

27.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Procesverbali

Neni 28

28.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve të tij mbahet procesverbali. Procesverbali përfshin emrat e anëtarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili prej tyre.

28.2 Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal, i caktuar nga shefi i personelit. Procesverbali duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Çdokush ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.

28.3 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar.

Konfliktet e interesave

Neni 29

29.1 Anëtari i Kuvendit apo anëtari i Komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ka interes personal apo material.

29.2 Secili anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është i pranishëm. Secili anëtar mund të ofrojë informacione që janë në interes të anëtarit tjetër.

29.3 Çdo anëtar mund të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, nëse konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

29.4 Para mbledhjes së parë të Kuvendit, anëtarët e Kuvendit shënojnë në një deklaratë të plotë dhe të hapur interesat e tyre financiare dhe këtë regjistër e mban Shefi i Personelit. Anëtarët e Kuvendit shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare, posa ato të ndodhin.

29.5 Kur ekzistojnë konfliktet e interesave, anëtarët e Kuvendit duhet të përjashtohen nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative.

29.6 Nëse vjen deri te ndonjë konflikt potencial i interesit, pasi që është marrë vendimi, ai duhet të pezullohet dhe çështja duhet të hetohet. Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit

Neni 30

30.1 Të gjithë anëtarët e Kuvendit kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e Kuvendit.

30.2 Anëtari i Kuvendit ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen me Rregulloren e Punës;

30.3 Anëtari i Kuvendit mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat do t'i bashkëngjiten procesverbalit;

30.4 Anëtari i Kuvendit mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të Kuvendit anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai mund t'i propozojë Kryesuesit të Kuvendit që të diskutohet ndonjë çështje që është në përgjegjësi të Kuvendit;

30.5 Anëtari i Kuvendit mund të kërkojë nga Kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si anëtar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai ose ajo mund ta ngrejë çështjen në Kuvendin e Komunës.

30.6 Anëtari i Kuvendit lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen e punëve të Kuvendit.

30.7 Kuvendi në pajtim me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore, mund t'iu ofroj kompensim anëtarëve të Kuvendit për punën e tyre në Kuvend.

30.8 Anëtarët e Kuvendit detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur, në komisionet ku ata janë anëtar, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Mandati

Neni 31

31.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit është katër vite.

31.2 Anëtari i Kuvendit pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- c) nëse anëtari ia paraqet Kryesuesit të Kuvendit dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit pa arsye;
- f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të pa përzgjedhshëm.

31.3 Anëtari i Kuvendit në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Shpërndarja e Kuvendit jo funksionues të Komunës

Neni 32

32.1 Nëse Kuvendi dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jo funksionues dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton Komunën për dështimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.

32.2 Kuvendi konsiderohet jo funksionues nëse:

- a) nuk e zgjedh kryesuesin tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
- b) nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit;
- c) nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës ose
- d) nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

32.3 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mos funksionimin e Komunës. Qeveria mund ta shpërndajë Kuvendin jo funksionues.

32.4 Zgjedhjet e reja për Kuvendin e Komunës mbahen në pajtim me ligjin për zgjedhjet komunale.

Komitetet e përhershme

Neni 33

33.1 Kuvendi themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

33.2 Kuvendi themelon komitete tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

33.3 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 34

34.1 Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvend.

34.2 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditivin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Komiteti i Komuniteteve

Neni 35

35.1 Komiteti i Komuniteteve përfshinë në radhët veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit, anëtarët tjerë janë nga përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në Komunë përfaqësohet nga së paku një përfaqësues në Komitetin e Komuniteteve. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.

35.2 Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik,

kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda Komunës.

Komitetet konsultative

Neni 36

36.1 Kuvendi themelon komitete konsultative sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

36.2 Anëtarësia e komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

36.3 Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e Kuvendit.

36.4 Kuvendi do të themeloj Këshillin Komunal për siguri në bashkësi.

Informimi i subjekteve të interesuara për mbledhjen e Kuvendit dhe Komiteteve

Neni 37

37.1 Mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve të Kuvendit, janë të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara për objektin e diskutimit, përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

37.2 Kuvendi nëpërmjet Zyrës për Informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme.

37.3 Njoftimet publike bëhen përmes:

- a) Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës;
- b) Mediave të shkruara dhe elektronike lokale dhe
- c) Faqes së internetit të Kuvendit.

37.4 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;
- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës.

37.5 Komitetet nëpërmjet Zyrës për Informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes;

- b) Kohën e mbledhjes;
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe
- d) Rendin e ditës.

Neni 38

Çdo anëtar i publikut i cili merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve të tij, me lejen e Kryesuesit të Kuvendit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes.

UDHËHEQËSIA KOMUNALE / EKZEKUTIVI

Zgjedhja e Kryetarit të Komunës

Neni 39

39.1 Kryetari i Komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale.

39.2 Kryetari i Komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare.

39.3 Mandati i Kryetarit të Komunës përfundon:

- a) kur ta kryej mandatin e tij;
- b) nëse vdes;
- c) nëse jep dorëheqje;
- d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se një muaj pa arsye;
- f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin nga cilësia juridike dhe
- h) në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë muaj ose më tepër.

Betimi

Neni 40

40.1 Me rastin e zgjedhjes, Kryetari jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit. Teksti i betimit është si në vijim:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Gjakovës me nder, besnikëri, në mënyrë të pa anshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t’i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

40.2 Kryetari që dështon ta japë betimin brenda një muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve e humbë mandatin.

Përgjegjësitë e Kryetarit

Neni 41

Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e Kuvendit;
- e) emëron dhe shkarkon zëvendësit e tij;
- f) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvend;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregulluese dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvend dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para Kuvendit për situatën ekonomike-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi;
- k) mund të kërkoj që Kuvendi ta shqyrtoj një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve;
- l) miraton udhëzime, urdhëresa dhe vendime administrative për situata të veçanta.

Konfliktet e interesit

Neni 42

42.1 Menjëherë pas zgjedhjes së tij, Kryetari i Komunës ndërpret çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësisë së tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

42.2 Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje në të cilën ai apo ndonjë i afërm i familjes së tij ka interes personal apo financiar.

42.3 Kryetari i Komunës duhet t'i paraqes konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

42.4 Kryetari i Komunës mundet vullnetarisht ta përjashtoj veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

Shkarkimi

Neni 43

43.1 Kryetari i Komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej tridhjetë ditëve nëse Kryetari ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

43.2 Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra të Kryetarit, ministria përgjegjëse për pushtet lokal do t'i rekomandoj Qeverisë së Republikës së Kosovës suspendimin e Kryetarit. Qeveria e Republikës së Kosovës brenda tridhjetë ditëve mund të suspendoj me vendim Kryetarin dhe t'i dorëzoj lëndën Gjykatës Kushtetuese.

43.3 Nëse Gjykata Kushtetuese e përkrah vendimin, Qeveria mund të shkarkoj nga detyra Kryetarin.

Nënkryetari i Komunës

Neni 44

44.1 Kryetari i Komunës ka një Nënkryetar.

44.2 Nënkryetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

44.3 Me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

44.4 Kur posti i Nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

44.5 Neni 42 për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohet *mutatis mutandis* edhe për Nënkryetarin.

Drejtoratet komunale

Neni 45

45.1 Administrata komunale organizohet në këto drejtorate:

1. Drejtorati për Punë të Përgjithshme Administrative,
2. Drejtorati për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
3. Drejtorati për Arsimi, Kulturë, Rini dhe Sport,
4. Drejtorati i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit,
5. Drejtorati i Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit,
6. Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
7. Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
8. Drejtorati për Shërbime Publike,
9. Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim,
10. Drejtorati për Punë Inspektuese.

45.2 Kuvendi Komunal mund të themeloj dhe bashkoj apo shkrij drejtori të tjera sipas nevojës së paraqitur.

45.3 Çdo drejtorat menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari.

Drejtorët komunal

Neni 46

46.1 Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

46.2 Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Konflikti i interesit për drejtorët

Neni 47

47.1 Drejtorët përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.

47.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen.

47.3 Rregullorja e punës përfshinë masat të cilat merren për të përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë ndeshje interesash.

Zyra Komunale e Komuniteteve

Neni 48

48.1 Zyra Komunale e Komuniteteve formohet me qëllim të përmirësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe të sigurimit të shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

48.2 Zyra Komunale e Komuniteteve është pjesë integrale e Komunës dhe e strukturës së përbashkët administrative të saj.

48.3 Zyra Komunale e Komuniteteve drejtohet nga një drejtues i cili zgjidhet sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil.

48.4 Personeli i zyrës së Komuniteteve gëzon status të personelit të shërbimit civil të Komunës.

Zyrat tjera Komunale

Neni 49

49.1 Kuvendi i themelon këto zyra komunale:

- a) Zyra - Njësia për të Drejtat e Njeriut,
- b) Zyra Ligjore,
- c) Zyra për Prokurimin Publik,
- d) Zyra e Avokatit Publik,
- e) Zyra e Komisionit për rregullimin e tokës bujqësore.

49.2 Kuvendi mund të themelojë edhe njësi-zyra tjera, sipas nevojave të paraqitura.

49.3 Avokatin Publik e zgjedhë Kuvendi.

49.4 Komisionin për rregullimin e tokës bujqësore e cakton Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me propozim të Komunës konform Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2006

Drejtoreti për Punë të Përgjithshme Administrative

Neni 50

Drejtoreti për Punë të Përgjithshme Administrative është përgjegjës për:

- a) kryerjen e detyrave që i përshkruhen me Ligj, Statut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit,
- b) detyrat dhe përgjegjësitë për integritet evropiane,
- c) shërbimin e përkthimeve në gjuhët zyrtare,
- d) organizimin e logjistikës që përfshijnë: transportin (vetura zyrtare), depon, arkivin dhe shkresëtarinë, postën, menaxhimin e pasurisë, shërbimin i sigurimit dhe mirëmbajtjes së objekteve komunale, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative, mirëmbajtjen e ueb faqes komunale,
- e) sigurimin e këshillave në zhvillimin organizativ dhe për formulimin, autorizimin dhe zbatimin e menaxhimit dhe programet zhvillimore të stafit,
- f) ofrimin e bashkëpunimit, këshillave dhe ndihmës për drejtorët e drejtorive tjera komunale si dhe personelit tjetër për të gjitha çështjet administrative,
- g) sigurimin e shërbimeve të teknologjisë informative,

Neni 51

51.1 Shërbimi i Ofiqarisë së Drejtorarit për Punë të Përgjithshme Administrative i ofron këto shërbime:

- a) lëshimin e certifikatës së gjendjes civile,
- b) regjistrimet e lindjeve,

- c) certifikatën e lindjes,
- d) certifikatës zëvendësuese të lindjes,
- e) certifikatës së kurorëzimit,
- f) certifikatës zëvendësuese të kurorëzimit,
- g) certifikatës së vdekjes,
- h) certifikatës së vendbanimit,
- i) certifikatës së gjendjes familjare
- j) certifikatës mbi statusin martesor,
- k) vërtetimi për vendqëndrim, identitet dhe vërtetimi për pranimin e mjeteve materiale,
- l) certifikatës për mbajtjen e familjes,
- m) certifikatës familjare për pensionistë nga bota e jashtme,
- n) vërtetimin për shtesa fëmijërore,
- o) vërtetimin e origjinalitetit të dokumentit,
- p) vërtetime të ndryshme sipas specifikave të tjera,
- q) regjistrimi i fëmijës së gjetur – braktisur (sipas aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale apo vendimit të Gjykatës),
- r) regjistrimet e mëvonshme të lindjeve,
- s) regjistrimin i fëmijëve të lindur në botën e jashtme,
- t) lidhja e martesave – kurorëzimit,
- u) kurorëzimin me shtetas të huaj,
- v) regjistrimet e martesave të bëra jashtë Kosovës,
- w) regjistrimin e vdekjeve,
- x) regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve,
- y) regjistrimin e vdekjeve të ndodhura jashtë Kosovës,
- z) vërtetimet mbi nënshtetësinë,
- zh) ndërrimin e emrit personal,
- xh) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

51.2 Në kuadër të Drejtoratit për Punë të Përgjithshme Administrative, Shërbimit të Ofiqarisë, funksionojnë edhe zyret e vendit të cilat do të veprojnë në kuadër të autorizimeve ligjore dhe atyre të bartura nga Kuvendi i Komunës.

Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 52

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor,
- b) vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi parësore,
- c) vendosjen e objektivave lokale për KPSH,
- d) zhvillimin e buxhetit, bazuar në nevojat lokale, duke iu përmbajtur udhëzimeve të MSH;
- e) propozimin e buxhetit dhe zbatimin (jetësimin) e buxhetit,
- f) vendosjen dhe mbledhjen e bashkë pagesave brenda kornizës së caktuar nga MSH,
- g) sigurimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore,
- h) mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel komunal,

- i) zbatimin e normave dhe standardeve të infrastrukturës, Burimeve Njerëzore të miratuara nga MSH,
- j) mbledhjen dhe analizimin e informatave në nivel lokal,
- k) shërbehet me informata për të përcaktuar prioritetet lokale dhe objektivat, në përputhje me strategjinë e kujdesit primar shëndetësor,
- l) shërbehet me të dhënat e nivelit qendror për të analizuar cilësinë e shërbimeve dhe përdorimin efektiv të burimeve,
- m) përkujdeset për masat e mbrojtjes shëndetësore që kanë të bëjnë me:
 - sigurimin e ujit të sigurt dhe higjienës,
 - sigurimin e ushqimit të sigurt dhe nutricionit,
 - aktivitetet e dezinfektimit, dezinfektimit, dhe deratizimit,
- n) bashkërenditjen dhe mbikëqyrjen e punëve me QKMF, QMF dhe me Ambulanca,
- h) zbatimin e Rregulloreve që lëshohen nga Departamenti i Shëndetësisë, MSH dhe MPMS,
- i) ndërmarrjen e fushatave sensibilizuese me organizata qeveritare dhe joqeveritare dhe hartimin e marrëveshjeve me to,
- j) raportimin mbi ofrimin e shërbimeve dhe të arriturat komunale në lëmin e shëndetësisë;
- k) Komuna ka të drejtë për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës,
- l) Komuna mund të vendosë për nivelin e qirasë dhe për nivelin e lirimit nga pagesa e qirasë,
- m) Kuvendi ka të drejtë që të vendosë për lirimet për shërbimet e kryera ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me Ligjin e aplikueshëm,
- n) bashkëpunimin me Qendrën për Punë Sociale të Komunës së Gjakovës për përkujdesjen e rasteve sociale të popullatës së kësaj komune.
- o) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Neni 53

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) ofrimin e mundësive të barabarta për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë,
- b) zhvillimin e arsimit lokal dhe aftësimit profesional,
- c) zhvillimin e të gjitha aspekteve tjera të arsimit lokal,
- d) respektimin dhe nxitjen e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për arsimin,
- e) nxitjen e bashkëpunimit midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, si dhe midis institucioneve arsimore dhe familjes,
- f) regjistrimin e të dhënave personale për nxënës, sipas formularit të miratuar nga MASHT dhe në harmoni me Ligjin,
- g) bashkëpunimin me MASHT-in në planifikimin dhe koordinimin e zhvillimit të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në Kosovë,

- h) planifikimin e zhvillimit të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunë, në konsultim me MASHT-in dhe komunat tjera,
- i) bashkëpunimin me drejtoritë e komunave tjera, në projekte të përbashkëta arsimore, në përdorimin e përbashkët të burimeve fizike dhe njerëzore, si dhe caktimin e fondeve për projekte dhe qëllime të këtilla,
- j) në marrëveshje me MASHT-in miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike, të niveleve 0, 1, 2, dhe 3 në Komunë,
- k) rregullon se cilat shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në Komunë,
- l) mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike, si dhe sigurimin e dispozitave për mirëmbajtje të shërbimeve mbështetëse për mirëqenien fizike të nxënësve, duke përfshirë ujë të freskët, ambiente banjash dhe shërbime shëndetësore,
- m) marrjen e masave për të siguruar që ambienti rrethues urban apo rural , në të cilin është e vendosur shkolla, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt në oborrin e shkollës,
- n) nxitjen në bashkëpunim me MASHT-in, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurinë në rrugë, fusha, të nxisë shtimin e edukatës shëndetësore për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse si dhe organizon aksione për sensibilizimin e komunitetit kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë,
- o) miratimin e pushimeve lokale të shkollës, në përputhje me Ligjin përkatës, dhe miratimin e rregullave të shkollës,
- p) përkujdesjen e pagesave të personelit mësimdhënës dhe teknik në institucionet arsimore të Komunës,
- q) shqyrtimin e vazhdueshëm të masave të marra për realizimin e arsimit special. Në realizimin e kësaj detyre në atë masë që është e nevojshme ose e dëshirueshme, Drejtoria konsultohet me MASHT-in dhe drejtoritë tjera komunale, për bashkërenditjen e arsimit të fëmijëve që kanë nevojë për arsim special,
- r) vlerësimin e nevojave speciale, siç përcaktohen me Ligj,
- s) hartimin dhe miratimin e Rregulloreve për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor, pasi të ketë marrë me parë propozimet e Këshillit të shkollës dhe komentet e drejtorit për këto Rregullore,
- t) hartimin e propozimit për arsimim special për nxënës dhe ofrimin e vlerësimit profesional,
- u) hartimin e propozimit për themelimin e shërbimit këshillimor dhe shëndetësor për nevojat speciale,
- v) të merr pjesë në përzgjedhjen e drejtorëve dhe mësuesve që punësohen në shkollat e Komunës,
- aa) që brenda Ligjeve të aplikueshme që e rregullojnë lëminë e kulturës, t'i menaxhojë resurset lokale kulturore, duke përfshirë muzetë lokale dhe resurset e trashëgimisë kulturore,
- bb) që për çdo vit të bëj publike shumën e buxhetit të disponueshëm për përgatitjen e aktiviteteve kulturore, duke përfshirë paratë e grandeve që janë në dispozicion të personave të kualifikuar dhe vendosjen e rregullave për dorëzimin e aplikacioneve të grandeve dhe dhurimit të grandeve,
- cc) të menaxhojë në kuadër të kompetencave ligjore me: Teatër, Bibliotekë, Arkiv, Stadiumin e Qytetit, Palestrën e Sporteve dhe Pallatin e Kulturës,

- dd) te kujdeset edhe për formacione të tjera nga kultura, rinia e sporti, që nuk kanë hapësirë dhe kushte pune,
- ee) të organizojë dhe shënojë data me rëndësi historike kur kjo gjë kërkohet,
- ff) të rishikojë raportet kontraktuese në lidhje me objektet e kulturës,
- gg) të grumbullojë shënime faktike mbi të arriturat në kulturë,
- hh) të bashkëpunojë ngushtë dhe të raportojë për punën e vet, Kuvendit, Kryetarit, dhe Komitetit për Arsim dhe Kulturë kurdo që kërkohet,
- ii) të bashkëpunojë me Departamente të nivelit qendror nga lëmi i kulturës, rinisë dhe sportit,
- jj) të mbajë regjistrin e grupeve, klubeve, ansambleve etj.
- kk) që në çdo vit të bëjë publike buxhetin për të siguruar aktivitete kulturore, të rinisë dhe sporteve, duke përfshirë grande për persona relevantë si dhe do të përpilojë Rregullore për dorëzimin e aplikacioneve për grande dhe caktimin e grandeve,
- ll) te grumbullojë shënime faktike mbi të arriturat në sport dhe çështjet rinore,
- mm) të bashkëpunojë me qytetet dhe shtetet tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ e organizata tjera,
- nn) të respektojë, të përkrahë dhe të ndihmojë asociacione, klube, shoqata dhe të krijojë individë me aftësi të posaçme kreative, pa bërë ndonjë dallim racor, gjinor, fetar, kombëtar, etj.
- oo) të joshë investitorët dhe të kërkojë fonde shtesë nga ata,
- pp) të organizojë debate për zhvillim dhe avancim të sportit,
- qq) të rishqyrtojë raportet kontraktuese në lidhje me objektet e sportit,
- rr) të krijojë kushte për kthimin e rinisë në vend dhe riedukimin e tyre,
- ss) të organizojë anketa, seminare e trajnime të ndryshme dhe kyçje e të rinjve në aktivitete rinore, evropiane e botërore,
- tt) përmbushë edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Neni 54

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) hartimin e rregulloreve komunale për çështjet financiare,
- b) përgatitjen e rregulloreve komunale për Komitetin për Politikë dhe Financa, nga fushëveprimi i financave,
- c) udhëheqjen e çështjeve financiare të Komunës,
- d) ndihmon Kryetarin dhe Komitetin për Politikë dhe Financa në përgatitjen e buxhetit vjetor të Komunës,
- e) mbajtjen e të gjitha llogarive në Komunë, për një proces transparent buxhetor, me një shkallë të lartë të mbikëqyrjes së drejtorive,
- f) përgatitjen e procedurave dhe raporteve të kontabilitetit, kryerjen e të gjitha pagesave pas miratimit nga drejtoria përkatëse dhe Kryetari, dhënien e komenteve mbi çështjet buxhetore para se të merret vendimi në Kuvend,
- g) mbajtjen e të gjitha llogarive në Komunë, integrimin në sistemin Free Balance, për mbajtjen e llogarive në proceset komunale të menaxhimit financiar,
- h) menaxhimin e fondeve komunale,
- i) kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës komunale

- j) dhënien e këshillave Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komiteteve tjera, mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin e komunës,
- k) për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare,
- l) për menaxhimin e thesarit,
- m) mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit,
- n) brenda kompetencave të veta, Komuna do të kërkojë krijimin e një kornize të përshtatshme për ekonomi të qëndrueshme lokale,
- o) në kontest të planit për zhvillim ekonomik Komuna mund të caktojë prioritetë për investime në Komunë, si dhe t'i koordinojë ato me MEF-in,
- p) hartimin e politikës së zhvillimit ekonomik, propozimin e marrjes së masave për zhvillimin ekonomik të Komunës,
- q) hartimin e planit global strategjik të zhvillimit ekonomik të Komunës, në aspektin afatshkurtër dhe në aspektin afatgjatë,
- r) hartimin e programeve ideore, duke i specifikuar veprimtaritë ekonomike me qëllim të zhvillimit të sektorëve parësorë, kontaktet me institucionet vendore financiare, si me banka dhe me institucione financiare ndërkombëtare, për t'u pajisur me informacione të mjaftueshme e të sakta, lidhur me kushtet e kreditimit (financimit) të bizneseve të ndryshme,
- s) dhënien e këshillave për afaristët e ndryshëm për mundësinë e investimeve, angazhimit të kapitalit të tyre në veprimtaritë prodhuese e fitimprurëse, por edhe perspektive,
- t) organizimin dhe menaxhimin e panairëve tradicionale të mallrave të ndryshme,
- u) dhënien e ndihmës në organizimin e konferencave ndërkombëtare për mundësinë dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të Komunës,
- v) për bashkëpunimin me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, rreth mundësisë së bashkërenditjes së punëve e të aktiviteteve për zhvillimin ekonomik të Komunës,
- w) për bashkëveprimin me ndërkombëtarët për bashkërenditjen e punëve rreth zhvillimit ekonomik të Komunës,
- x) dhënien e informatave dhe raporteve të punës, për periudha të caktuara për nevojat e institucioneve Komunale,
- y) dhënien e lejes së punës, arkëtimin e pagesave të lejeve të punës, evidentimin e ndryshimeve në leje të punës dhe në certifikatat e biznesit, dhënien e formularëve për aplikim dhe njoftim paraprak për bizneset, dhënien e informatave profesionale dhe raporteve për drejtoritë dhe institucionet e Komunës,
- z) evidentimin e të gjithë obliguesve tatimorë ndaj Komunës dhe arkëtimin e të hyrave përkatëse,
- aa) formimin e politikës vjetore turistike dhe propozimin e masave me të cilat do të nxitet sektori privat, për t'i arritur synimet e politikës së zhvillimit të turizmit,
- bb) nxitjen e zhvillimit të veprimtarisë turistike për prodhimin e produkteve të reja turistike dhe të produkteve interesante për tregun, por edhe rritjen e cilësisë së ofertës turistike në nivel lokal.
- cc) të caktoj komisionet për mbikëqyrje profesionale në realizimin e projekteve komunale,
- dd) dhënien e pëlqimit mjedisor për eksploatimin e resurseve natyrore
- ee) përmbushë edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Neni 55

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës,
- a) sigurimin e zbatimit të ligjit dhe vendimeve tjera të aplikueshme nga fushëveprimi i planifikimit urban,
- b) organizimin dhe bashkërenditjen e aktiviteteve në lëmin e planifikimit urban dhe rural, hartimin e detyrave projektuese dhe menaxhimin e procesit të hartimit të planeve urbanistike dhe projekteve tjera ekzekutive sipas nevojave të Komunës,
- c) përgatitjen dhe hartimin e akteve administrative komunale, lidhur me planifikimin urban dhe rural,
- d) bashkëpunimin me institucionet e Komunës, me rastin e përgatitjes dhe hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planit Zhvillimor Urban, Planeve Rregulluese dhe Planeve tjera,
- e) caktimin e kushteve për rregullimin e hapësirës,
- f) bashkëpunimin me Kuvendin, Komitetin e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe organet tjera të Komunës, kur ato trajtojnë çështje nga lëmi i Planifikimit Urban dhe Rural,
- g) iniciimin e procedurave për rregullimin e tokës ndërtimore dhe programeve nga kjo lëmi, respektivisht eksproprijimin e dhe eksproprijimin dhe përgatitjen e tokës me infrastrukturë komunale,
- h) këshillimin e palëve për procedurën dhe mënyrën e realizimit të të drejtave nga lëmi i urbanizmit,
- i) përpunimin e kërkesave për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcaktimin e kushteve urbanistike për zbatimin e PZHK, PZHU, Planeve Rregulluese dhe Planeve tjera të miratuara në Kuvend,
- j) të jep shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore, ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parashtruara të ndërtimit – jep pëlqime urbanistike dhe leje urbanistike,
- k) lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe përdorimit,
- l) të jep pëlqimin e rregullimit të infrastrukturës komunale,
- ll) hartimin e planit për vendosjen dhe ndërtimin, si dhe caktimin e kushteve për objektet me karakter të përkohshëm në përputhje me ligjin dhe vendimet e aplikueshme dhe mbanë evidencën e tyre – objektet montuese dhe montuese, panot reklamuese dhe bilbordat,
- m) që të bëjë përgatitjen dhe hartimin e projekt-rregulloreve, projekt-vendimeve, propozimeve të këshillave profesionale, për miratim në Kuvend,
- n) bashkëpunimin me organet tjera të Administratës Komunale, lidhur me lëndët dhe kontestet gjyqësore,
- o) që të ndihmojë në përgatitjen e lëndëve për Gjykatë dhe subjekte tjera kompetente në zbatimin e ligjit dhe dispozita tjera nga lëmi i urbanizmit dhe rindërtimit,
- p) që të bëjë protokollimin, evidentimin, përpunimin, arkivimin e lëndëve që i drejtohen drejtorisë, arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit teknik dhe investor-teknik,

- r) lidhjen e kontratave mbi dhënie me qira të tokës ndërtimore dhe hapësirave të lira publike komunale, gjithmonë në harmoni me planifikimin, ligjin dhe rregulloret komunale,
- t) shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për kthimin, respektivisht de eksproprijimin e tokës pronarëve të mëparshëm, gjithmonë sipas ligjit,
- u) zbatimin e procedurës për eksproprijimin e patundshmërive
- v) marrjen nga pronësia të tokës ndërtimore me qëllim të përgatitjes së tokës për qëllimin e paraparë sipas planit detal urbanistik,
- w) që në bashkërenditje me shkollat dhe shoqërinë civile të ofroj informata publike dhe publicitet për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin,
- x) që të ndihmoj në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave, brenda territorit të Komunës,
- y) që të siguroj mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit,
- z) kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, ngritja e sipërfaqeve të gjelbra dhe mbrojtja e atyre ekzistuese, vetëdijesimi i popullatës,
- aa) nxitjen e investimit në lëmin e mjedisit.
- bb) parandalimin dhe uljen e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve tjera të çfarëdo lloji
- cc) ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore dhe shmangien e mbi shfrytëzimit – keqpërdorimit të tyre,
- dd) riaftësimin ekologjik të zonave të dëmtuara nga veprimtaria antropike ose fenomenet natyrore shkatërruese,
- ee) ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës,
- ff) bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- gg) evidenton dhe administron me objektet e banimit në pronësi të Komunës,
- hh) përbushë edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Neni 56

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) kadastra kryen matje gjeodezike sipas kërkesave të personave juridikë, fizikë si dhe kërkesave të organeve të administratës,
- b) kadastra mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive,
- c) kadastra është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrorë, rrjetën referuese homogjene për sigurimin e Hartave Orto-Foto, rikonstruktimin e informatave kadastrorë në formë digjitale, modulën e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën,
- d) vlerësimin e pronës sipas kriterëve, standardeve dhe rregulloreve në fuqi,
- e) siguron zotërimin e tokës dhe patundshmërinë ,
- f) planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- g) digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrorë) ,

- h) azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat të dhëna për transformim,
- i) shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- j) ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e eksproprijimit,
- k) incizimin e sipërfaqes së ndërtesave dhe përpunimin e skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- l) regjistrimin e pronës së paluajtshme në regjistrin e tokës komunale,
- m) zhvillimin e procedurave të regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesës së palëve,
- n) korrigjimin e regjistrit sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave pozitive në fuqi, lidhur me regjistrimin e pronës,
- o) azhurnimin e pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënime të tjera nga dokumentacioni arkivor; azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve në bazë të matjeve nga tereni,
- p) mbajtjen e evidencës dhe udhëheqjen me kadastrën etazh të ndërtesave,
- r) kryerjen e procedurave rreth dhënies së tokës për shfrytëzim,
- s) përgatitjen e specifikimeve për tender për kryerjen e punëve që bënë,
- t) mbrojtjen e pronës komunale nga uzurpimet dhe udhëheqjen e procedurave lidhur me këtë çështje,
- u) zbatimin e procedurave të Ligjit mbi kadastrën, të LPA, Ligjit mbi hipotekat, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe akteve dhe dispozitave të tjera ligjore,
- v) zbatimin e dispozitave të Ligjit për Qarkullimin e Patundshmërive, me të cilat rregullohet çështja e ndërrimit të patundshmërive,
- w) zbatimin e dispozitave ligjore me të cilat është rregulluar procedura e rreambullimit (arondimit) të tokave,
- x) mbajtja e regjistrit të kontratave mbi dhënien në shfrytëzim të pronës komunale,
- y) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtorati për Shërbime Publike

Neni 57

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) përcjelljen e punimeve të veprimtarisë së shërbimeve publike, në tërë territorin e Komunës,
- b) menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale,
- c) monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve e hapësirave tjera komunale, mirëmbajtjen dhe rregullimin e ndriçimit publik, dhe punimin e kanalizimeve, rrugëve, ndriçimeve të reja, etj.,
- d) përcjelljen e mirëmbajtjes së gjelbërimit të qytetit, menaxhimin e tregjeve, mirëmbajtjen e të gjitha varrezave të miratuara me vendim të Kuvendit,
- e) hartimin e propozim-projekteve për rregullimin e rrugëve, parqeve dhe çështjeve tjera me interes për Komunën,
- f) përkujdeset për rregullimin e komunikacionit në zonën urbane komunale dhe zonën rurale,
- g) lëshimin e lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarive të subjekteve të cilët merren me veprimtarinë e qarkullimit të automjeteve, bartjes së udhëtarëve etj,

- h) përgatitjen e projekteve për vendosjen e sinjalizimit horizontal, vertikal dhe me drita,
- i) kryerjen e mbikëqyrjes së kompanive të angazhuara në menaxhimin e parkingjeve publike si dhe kompanive të cilat e bëjnë bartjen dhe ruajtjen e automjeteve të sekuestruara nga policia si dhe përgatitjen e shpalljeve për shitjen e këtyre automjeteve, përmes procedurës së ankandit publik,
- j) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Neni 58

Ky Drejtorat është përgjegjës për:

- a) hartimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera në pajtim me Udhëzimet Administrative të organit kompetent qeveritar,
- b) vlerësimin e rrezikshmërisë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim, ndërmerr masa parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera,
- c) planifikimin dhe realizimin e masave për mbrojtje dhe shpëtim,
- d) vështirimin, lajmërimin dhe alarmimin e popullsisë për kërcënim rreziku,
- e) organizimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për alarmim, në përputhje me sistemin unik të alarmimit,
- f) themelimin e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, organizimin e komiteteve, njërive dhe i shërbimeve të forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe i forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- g) propozimin e formimit të njërive për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera si dhe kryen plotësimin e tyre me obligues dhe kompletton ato me mjete adekuate për veprim në raste të fatkeqësive të tjera,
- h) përgatitjen e programeve për aftësim, në pajtim me organin qeveritar,
- i) që të kujdeset për sigurimin dhe mirëmbajtjen e rezervave të mjeteve materiale për raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera,
- j) harmonizimin e planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në bashkëveprim me komunat fqinje,
- k) që të kryej edhe punë të tjera nga lëmi i mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me organet kompetente komunale dhe qeveritare,
- l) hartimin dhe i mbikëqyrjen e programeve për rastet e ndërhyrjeve emergjente,
- m) që të bashkërendit punët lidhur me bashkëpunimin emergjent me FSK-në (TMK-në), SHPK-në dhe KFOR -in
- n) që të përkujdeset për sigurinë civile dhe kontakte me policinë,
- o) bashkërenditjen e punëve me qendrën për alarmim dhe koordinim emergjent (QAKE-112),
- p) bashkërenditjen dhe mbikëqyrjen e punës së Brigadës së Zjarrfikësve,
- r) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoreti për Punë Inspektuese

Neni 59

Ky Drejtoreti është përgjegjës për:

- a) mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e:
- b) Inspektoretit të Tregut;
- c) Inspektoretit Sanitar dhe të Veterinarisë;
- d) Inspektoretit Komunal dhe të Komunikacionit;
- e) Inspektoretit të Ndërtimtarisë;
- f) Inspektoretit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë;
- g) harton rregullore lokale për të gjitha veprimtaritë inspektuese të përshkruara më lartë;
- h) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Drejtoreti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Neni 60

Ky Drejtoreti është përgjegjës për:

- a) ruajtjen e tokave bujqësore nga degradimet fizike dhe kimike,
- b) hartimin e programeve për zhvillimin e të gjitha degëve të bujqësisë,
- c) hartimin e programeve për industrinë përpunuese të produkteve bujqësore dhe për investime kapitale në infrastrukturën e bujqësisë,
- d) mbikëqyrjen e zhvillimit të bujqësisë dhe prodhimin e ushqimit në Komunë,
- e) mbikëqyrjen e veprimtarisë në lëmin së pylltarisë dhe kujdeset për mbikëqyrjen e resurseve pyjore,
- f) mbikëqyrjen dhe hartimin e programeve për mirëmbajtjen e sistemeve të vjetra që nuk përfshihen me Hidrosistemin “Radoniqi”,
- g) hartimin e programeve për ruajtjen dhe shumimin e peshqve në lumenj dhe liqene.
- h) mbikëqyrë aktivitetet që synojnë zhdukjen e insekteve, parazitëve, sëmundjeve të bimëve apo shkaktarëve të tjerë destruktiv në natyrë,
- i) merr pjesë dhe mbikëqyrë aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit që kanë të bëjnë bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkimin dhe menaxhimin e resurseve ujore sipas Ligjit të ujit,
- j) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbikëqyrë kontrollin e cilësisë së ushqimeve dhe lëndëve të para bujqësore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit,
- k) hartimin e programeve të zhvillimit të hortikulturës dhe agrobiznesit,
- l) përmbush edhe detyrat dhe urdhëresat që i caktohen nga Kryetari dhe Kuvendi.

Neni 61

Zbatimin e të gjitha përgjegjësiave të përshkruara në nenet: 50,51,52,53,54,55,56,57,58,59, dhe 60 të këtij Statuti, do ta bëjnë drejtoret e drejtorive përkatëse, në koordinim dhe bashkëpunim të ndërsjellët, nën mbikëqyrjen e Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës.

ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 62 Shërbimi civil komunal

62.1 Shërbimi civil komunal përfshinë të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- a) Kryetarit, Nënkryetarit dhe Drejtorëve komunal,
- b) Kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

62.2 Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e Komunës dhe nëpunësit civil të administratës së Komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

62.3 Zgjedhjet për Kuvendin e Komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civil.

Administrata komunale dhe udhëheqësi i personelit

Neni 63

63.1 Administrata komunale organizohet në drejtorate. Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori. Drejtorët komunal emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari.

63.2 Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit.

63.2.1 Udhëheqësi i personelit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) bashkërenditjen e planifikimit të burimeve njerëzore dhe administrimin e punësimit të personelit,
- b) udhëheqjen, motivimin dhe zhvillimin e ekipit të personelit, për të ngritur nivelin e përkushtimit (mënyrës së kryerjes së punës) dhe për të dhënë shërbime cilësore,
- c) kontributin në shtimin e cilësisë së kryerjes së punëve dhe standardeve të kualitetit për të gjithë stafin, gjë e cila do të përforcojë funksionimin e procedurave të personelit siç janë: disiplina, vlerësimi i përgjithshëm dhe vlerësimi i punës,
- d) sigurimin e funksionimit të përditshëm të procedurave siç janë: rekrutimi dhe përzgjedhja, disiplina, ankesat, lutjet, vlerësimet e përgjithshme në konsultimet me menaxherët e drejtpërdrejtë, duke përfshirë edhe trajnimet e paneleve dhe komisioneve të nevojshme për t'i vënë në funksion këto procedura,
- e) krijimin dhe mirëmbajtjen e komunikimit efektiv dhe bashkëpunimin me të gjitha funksionet në komuna, në lidhje me çështjet e burimeve njerëzore,
- f) sigurimin e integritetit të parimeve të mundësive të barabarta në të gjitha aspektet e punës së njësisë për menaxhimin e burimeve njerëzore,
- g) kontributin në zhvillim dhe arritje të standardeve kualitative të administrimit dhe veprimtarisë së Komunës, siç janë: disiplina në punë dhe vlerësimi i rregullt i të arriturave në punë.

63.3 Kryetari shpall, rekruton dhe largon udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm për shërbim civil.

63.4 Nëse posti i udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët, Kryetari i Komunës emëron një anëtar të lartë të shërbimit civil komunal në cilësinë e kryesit të detyrës së udhëheqësit të personelit.

63.5 Brenda gjashtëdhjetë ditësh, Kryetari rekruton udhëheqësin e personelit në pajtim me nenin 63.3 të këtij statuti.

Konfliktet e interesit

Neni 64

Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

Informimi publik dhe konsultimi

Neni 65

65.1 Çdo Komunë mban periodikisht së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Data dhe vendi i takimit publikohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

65.2 Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e Komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

65.3 Përveç takimeve publike të cekura më lartë Komuna është e obliguar t'i informoj qytetarët e Komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik.

65.4 Kuvendi miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të Komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të Komunës.

65.5 Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga Komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

E drejta e peticionit

Neni 66

Çdo person apo organizatë me interes në Komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në Kuvendin e Komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës. Kuvendi shqyrton peticionin në pajtim me Rregulloren e punës.

Iniciativa e qytetarëve

Neni 67

67.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të Komunës, për miratim nga Kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.

67.2 Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar Kryesuesit të Kuvendit.

67.3 Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi.

67.4 Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtoj rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Referendumi

Neni 68

68.1 Referendumi organizohet për çështje të caktuara të cilat iniciohen nga Kuvendi apo me kërkesën e së paku 10% të votuesve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrje në referendum kanë të drejtë vetëm votuesit e regjistruar në regjistrin e zgjedhjeve komunale.

Propozimi për miratimin e vendimit për referendum duhet ta ketë edhe tekstin e marrjes së përgjigjes “PO” ose “JO”, respektivisht “PËR” ose “KUNDËR”, vlerësimin mbi koston financiare dhe burimet nga të cilat do të sigurohen këto mjete, si dhe listën me nënshkrime të emrave, mbiemrave dhe adresat e të gjithë parashtruesve të kërkesës për organizimin e referendumit.

68.2 Kuvendi e cakton datën kur do të mbahet referendumi.

68.3 Zhvillimi i referendumit mund t'i besohet edhe ndonjë institucioni të përcaktuar sipas ligjit.

68.4 Qytetarët e Komunës mund të kërkojnë që edhe Rregullorja e Kuvendit e miratuar nga Kuvendi i Komunës, t'i nënshtrohet referendumit.

68.5 Kërkesa duhet t'i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar.

68.6 Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit, në pajtim me ligjin në fuqi

Largimi i Kryetarit

Neni 69

69.1 Qytetarët e Komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e Kryetarit të Komunës.

69.2 Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga 20% e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.

69.3 Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e Kryetarit, zgjedhjet e reja për Kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet.

Procedurat buxhetore

Neni 70

Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e Kryetari të Komunës, të cilat përgjegjësi edhe mund të barten tek drejtori i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Përfshirë nga këto çështje bëjnë ato që janë të rezervuara për Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin.

Neni 71

Drejtorët e drejtorateve të komunës do ta mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese brenda drejtorateve të tyre, si dhe duhet t'i japin të gjitha informatat drejtorit të Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Auditorit të Brendshëm.

Neni 72

Drejtori i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim duhet t'i japë këshilla financiare Kryetarit të Komunës dhe komiteteve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga këto organe të Komunës.

Neni 73

Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të komunës janë të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Neni 74

Drejtori i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim do të paraqesë procedura, rregullore dhe rregulla tjera financiare, që do të jenë në përputhshmëri me procedurat e ligjeve në fuqi, rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, për të promovuar një administrim të fortë financiar brenda komunës dhe nga personeli i komunës.

Neni 75

Përcaktimi i të gjitha lartësive të tatimeve, tarifave dhe pagesave, si dhe ndryshimi i këtyre kritereve të tatimeve, tarifave dhe pagesave duhet të miratohet nga Kuvendi.

Neni 76

Drejtori i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të procesit të buxhetit, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij dhe ciklin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun.

Neni 77

77.1 Konsultimet me publikun duhet të mbahen në kohën ndërmjet datës 15 prill dhe 15 qershor, në mënyrë që t'u mundësohet të gjithë qytetarëve brenda komunës që t'i japin mendimet e tyre për të hyrat dhe propozimet për investime të buxhetit.

77.2 Takimet konsultative, ku përfshihen të gjitha pjesët e komunës, duhet të lajmërohen nëpërmjet mediave lokale një javë para mbajtjes së tyre dhe drejtori i Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim duhet të sigurojë që të gjitha propozimet për investime në infrastrukturën sociale janë evidentuar.

77.3 Propozimet duhet t'i dërgohen Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit, së bashku me vlerësimin objektiv të drejtorit për vlerësimin e çmimit dhe prioriteteve.

77.4 Konsultimet e buxhetit gjithashtu përfshijnë edhe informimin e qytetarëve për potencialin e të hyrave komunale, duke përfshirë edhe tatimin në pronë dhe masën në të cilën këto të hyra do të mblidhen.

77.5 Viti fiskal i komunës fillon me 1 Janar. Kryetari ia paraqet Kuvendit buxhetin për miratim sa më shpejtë që praktikisht është e mundur, pas njoftimit për lartësinë e fondit të ndarë për vitin vijues.

Auditimi i brendshëm

Neni 78

78.1 Komuna ka obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

78.2 Komuna ka të drejtë për të themeluar një shërbim autonom të auditimit në komunë, apo për të siguruar auditim të brendshëm nga një firmë e akredituar e auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Raporti vjetor

Neni 79

Kryetari i Komunës në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa e publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës. Raporti i prezantohet Kuvendit për miratim, jo më vonë se më 30 maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për atë vit fiskal. Raporti duhet të sqarojë mënyrën e financimit të secilit prej aktiviteteve dhe duhet të tregojë gjendjen financiare të komunës në fund të atij viti fiskal. Ai duhet të përfshijë edhe deklaratat për kontrollin financiar. Këto kërkesa duhet të përfshijnë edhe veprimtaritë e ndërmarrjeve komunale, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe marrëveshjet e bëra me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Neni 80

Në mënyrë që të përmbushen përgjegjësitë për raportim të Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të ndërmerren veprimet si në vijim:

1. Në buxhetin vjetor duhet të përfshihen objektivat e Komunës në lidhje me aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Komuna.
2. Objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme.
3. Duhet të ndërtohen mekanizmat përmes të cilave monitorohet arritja e objektivave.
4. Të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes të cilave sigurohet përmbushja e tyre.

MARRËDHËNJET NDËRMJET QEVERISË QENDRORE DHE LOKALE

Objektivat e shqyrtimit administrativ

Neni 81

Shqyrtimi administrativ i Komunës ka objektivat vijues:

- a) të forcoj aftësinë e organeve të vetëqeverisjes lokale në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre përmes këshillimit, mbështetjes dhe ndihmës;
- b) të siguroj ligjshmëri të aktiviteteve të organeve të vetëqeverisjes lokale;
- c) të siguroj që të drejtat dhe interesat e qytetarëve të respektohen.

Parimet themelore të shqyrtimit administrativ

Neni 82

82.1 Shqyrtimi administrativ i Komunës ushtrohet në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

82.2 Nuk mund të ushtrohet ndonjë shqyrtim paraprak nëse nuk parashihet ndryshe me Ligjin.

82.3 Shqyrtimi administrativ duhet të ketë sa më pak që të jetë e mundur, ndikim në interesat e vetëqeverisjes lokale dhe nuk duhet të kufizoj të drejtën e autoriteteve lokale në menaxhimin e çështjeve publike që bien në fushën e autoritetit të tyre, në pajtim me Ligjin.

82.4 Intervenimi i autoritetit mbikëqyrës duhet të jetë proporcional me rëndësinë e interesave të cilat synon t'i mbrojë.

Autoritetet mbikëqyrëse

Neni 83

83.1 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale është autoriteti mbikëqyrës, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e Komunës nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme.

83.2 Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato.

Përgjegjësitë e ndërsjella dhe procesi i shqyrtimit administrativ

Neni 84

84.1 Autoritetet komunale dhe mbikëqyrëse obligohen për të bashkëpunuar me njëri tjetrin në procesin e shqyrtimit.

84.2 Të gjitha masat e shqyrtimit ndërmerren nga autoritetet mbikëqyrëse në bazë të akteve përkatëse administrative. Aktet e tilla ofrojnë bazën ligjore dhe shpjegojnë arsyet e zbatimit të masës së një mbikëqyrjeje të caktuar.

Të drejtat e autoritetit mbikëqyrës për të qenë të informuar

Neni 85

85.1 Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të marrë dhe sigurojë informata të plota për të gjitha çështjet, përfshirë të drejtën për t'i vizituar zyrat komunale dhe objektet komunale dhe të drejtën për të kërkuar qasje në dokumentet komunale. Kryetari është përgjegjës për t'ia vënë në dispozicion informacionet autoritetit mbikëqyrës.

85.2 Gjatë vizitave të tilla, përfaqësuesit e autoritetit mbikëqyrës nuk i japin udhëzime të drejtpërdrejta stafit të organeve lokale vetëqeverisëse. Çdo kërkesë për dokumente i adresohet organit të qeverisjes lokale dhe shpërndarja e dokumenteve sigurohet nga Kryetari në pajtim me paragrafin 1 të nenit 77 të Ligjit.

85.3 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale ka të drejtën për të qenë e informuar rregullisht nga Komuna në fushat në të cilat ministria nuk është autoritet mbikëqyrës.

Llojet e shqyrtimit

Neni 86

86.1 Shqyrtimi i funksionimit të Komunës në fushën e kompetencave vetanake dhe të zgjeruara kufizohet në shqyrtimin e ligjshmërisë.

86.2 Shqyrtimi administrativ i funksionimit të Komunës në fushën e kompetencave të deleguara i nënshtrohet mbikëqyrjes së ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së veprimeve.

Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë

Neni 87

87.1 Kryetari i dërgon autoritetit mbikëqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga Kryetari dhe Kuvendi në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji.

87.2 Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë

Neni 88

88.1 Aktet në vijim i nënshtrohen procedurës së shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë:

- a) aktet e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi;
- b) vendimet lidhur me aktivitetet e përbashkëta të partneriteteve për bashkëpunim;
- c) aktet e miratuara brenda kornizës së implementimit të kompetencave të deleguara.

88.2 Komuna obligohet që t'ia dorëzoj aktet e përmendura autoritetit mbikëqyrës brenda 7 dite nga dita e nxjerrjes së tyre.

88.3 Autoriteti mbikëqyrës vërteton pranimin e aktit të qeverisë lokale përmes regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës.

88.4 Autoriteti mbikëqyrës obligohet që të jap mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë.

Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë

Neni 89

89.1 Nëse autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt i Komunës nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ai mund të kërkojë që Komuna ta ri-shqyrtoj vendimin apo aktin e tillë. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së Kushtetutës apo ligjeve dhe nuk suspendon ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve tjera.

89.2 Organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës.

89.3 Nëse Komuna pranon kërkesën për rishqyrtim, ajo mund të suspendojë ekzekutimin e vendimit të kontestuar apo aktit deri në shqyrtimin e saj nga autoritetet lokale.

89.4 Nëse Komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtoj aktin në fjalë në Gjykatën e Qarkut që është kompetent për territorin e komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar.

89.5 Gjykata e Qarkut mund të urdhërojë, si masë të përkohshme, suspendimin e zbatimit të vendimit apo aktit të kontestuar apo akteve të tjera të përkohshme në pajtim me ligjin në zbatim.

Kërkesa për konsultim paraprak

Neni 90

90.1 Para nxjerrjes së një akti, organi komunal mund të kërkojë konsultim me autoritetin mbikëqyrës.

90.2 Kërkesa për konsultime paraprake përmban draftin e aktit që synohet të nxirret dhe çështjen e posaçme për të cilën kërkohet këshilla e autoritetit mbikëqyrës për sa i përket ligjshmërisë dhe/ose arsyeshmërisë së aktit në fjalë.

90.3 Autoriteti mbikëqyrës obligohet të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditësh pas pranimi të kërkesës.

Shqyrtimi i përshtatshmërisë

Neni 91

91.1 Autoriteti mbikëqyrës përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes së kompetencave të deleguara ka të drejtë të kërkoj brenda 30 ditëve nga data e pranimi të kopjes së aktit, që organi i vetëqeverisjes lokale ta modifikoj apo shfuqizoj aktin e kontestuar në bazë të shqyrtimit të përshtatshmërisë.

91.2 Nëse organi komunal nuk vepron sipas kërkesës, organi mbikëqyrës përgjegjës për ushtrimin e mbikëqyrjes së përshtatshmërisë mund ta modifikoj, zëvendësoj aktin apo suspendoj ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.

91.3 Autoriteti mbikëqyrës informon organin komunal për vendimin e marr brenda 5 ditësh nga data e miratimit të vendimit.

Ankesat e qytetarëve

Neni 92

Ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve komunale shqyrtohen sipas ligjit për procedurën administrative.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 93

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të Statutit me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale aplikohen dispozitat e këtij Ligji.

Neni 94

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit të tij nga Kryesuesi.

Neni 95

95.1 Pas miratimit të këtij Statuti pushojnë të vlejnjë të gjitha dispozitat e statutit 01 Nr 011-2920 të dt. 28.04.2008.

95.2 Pas miratimit të këtij Statuti, të gjitha aktet tjera të Komunës duhet të harmonizohen me statutin në fuqi.

Neni 96

Plotësimet dhe ndryshimet e dispozitave të këtij Statuti bëhen sipas procedurës së miratimit të tij.

Neni 97

Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.


Gjakovë, 26.12.2008

Kryesuesi i Kuvendit

Agim Koci



REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - GJAKOVË
SKUPŠTINA OPŠTINE DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KOMUNA E GJAKOVËS

Kuvendi i Komunës

01 Nr. 011-332/2010

Datë 21.01.2010

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 45, paragrafi 45.2 të Statutit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.01.2010, pas diskutimit lidhur me pikën e VI-të, të rendit të ditës: Marrja e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gjakovës, themelimin e dy drejtorive të reja, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e plotësimit të Statutit të Komunës së Gjakovës të dt. 26.12.2008

Neni 1

- 1.1 Themelohet drejtoria për Zhvillim Ekonomik;
- 1.2 Themelohet drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Neni 2

- 2.1 Neni 45 i Statutit të Komunës së Gjakovës, ndryshohet dhe plotësohet ashtu që strukturës organizative të drejtorive komunale i shtohen edhe dy drejtori të parapara në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 3

- 3.1 Ky vendim është pjesë përbërëse e Statutit të Komunës të datës 26.12.2008.

Neni 4

- 4.1 Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit të tij nga ana e Kuvendit të Komunës.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 21.01.2010, pas shqyrtimit të pikës së VI-të, të rendit të ditës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, edhe me dy drejtori komunale të propozuar nga ana e Kryetarit të Komunës, konform nenit 12, pika 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, me votim të më shumë se dy të tretave të anëtarëve të zgjedhur të kuvendit, e miratoi propozimin e kryetarit të Komunës për themelimin e dy drejtorive: Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Bazuar në theksimet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

CO: Kryetarit të Komunës,
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe
Arkivës



Kryesuese e KK-ës,
znj. Teuta Haxhiu